

## Fletushka e Fakteve mbi Kohën Shtesë për Siguruesit Individualë të Shërbimit

Kjo fletushkë e fakteve synon të ndihmojë Siguruesit Individualë të Shërbimit që të kuptojnë rregullat mbi kufijtë e javës së punës dhe orëve shtesë. Ju lutemi kontaktoni menaxherin e çështjes së klientit ose shkoni te [www.dshs.wa.gov/altsa/IPOT](http://www.dshs.wa.gov/altsa/IPOT) për më shumë informacion.

### INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI ORËT SHITESË

#### 1. Ç'farë është një 'javë pune'?

Një javë pune fillon të dielën në 12:00 paradite (mesnatë) dhe përfundon të shtunën që pason më 11:59 pasdite.

#### 2. Ç'farë është një Kufi i Javës së Punës (WWL)?

Një WWL është numri gjithsej i orëve të shërbimit që mund të punoni në një javë të punës. Një ligj shtetëror i Washington-it më 2016 vendosi një kufi mbi numrin e orëve që një Sigurues Individual i Shërbimit (IP) mund të punojë në një javë të punës. Të gjithë IP-të kanë një kufi të javës së punës (WWL). Mund të punoni vetëm deri në WWL tuaj kur ato orë u janë caktuar nga një ose më shumë klientë dhe klienti për të cilin punoni kualifikohet për t'i marë orët. Klienti nuk mund të caktojë më shumë sesa orët e vlerësuara mujore në Planin e Kujdesit të tyre. WWL-të ndihmon në kontrollin e kostove të orëve shtesë, për të siguruar se financimi për shërbimet mbetet në dispozicion për ata të cilëve u nevojiten.

#### 3. Si e përcakton DSHS WWL tim të përhershëm dhe si mund t'a di WWL time të përhershëm?

Një ligj shtetëror u miratua në prill 2016. Ky ligj krijoi një WWL prej 40 orësh për të gjithë IP-të, përveç atyre që punuan mesatarisht më shumë se 40 orë shërbimi në javë në janar 2016. WWL-të mbi 40 orë u përcatuan duke ndarë orët e shërbimit të paguar të IP-së të janarit 2016 me 4.22 dhe duke rrumbullakosur tek çereku më i afërt i orës. Në Maj 2016, DSHS u dërgoi njoftime IP-ve që punuan në janar 2016 me informacionin e tyre të WWL-së. Asnjë WWL i përhershëm nuk mund të kapërcejë më shumë se 65 orë. Nëse filluat të punoni si një IP pas janarit 2016, WWL juaj është 40 orë.

#### 4. Po nëse mendoj se WWL im i përhershëm u përcaktua në mënyrë të gabuar?

Nëse mendoni se WWL juaj u përcaktua në mënyrë të gabuar, mund të paraqisni një kërkesë pranë menaxherit të çështjes të klientit dhe DSHS do të shqyrtojë orët tuaja sipas Kodit Administrativ të Uashingtonit 388-114-0050.

#### 5. A do të ndryshojë ndonjëherë WWL im i përhershëm?

Nëse WWL juaj i përhershëm është ndërmjet 60.25 dhe 65 orë, ai do të pakësohet në 60 orë më 1 korrik 2017 përveç nëse ka një ndryshim në ligj. Përndryshe, WWL juaj i përhershëm nuk do të ndryshojë përsa kohë që mbeteni të kualifikuar si një IP. WWL juaj gjithashtu do të mbetet i njëjtë nëse keni një ndërprerje të shërbimit dhe ktheheni si një IP në të ardhmen.

#### 6. Cilat shërbime përfshihen në orët e shërbimit në WWL tim?

- Kujdesi Personal
- Kujdesi për Ndihmë
- Trainimi për Marrjen e Aftësive
- Kujdesi për Pushim

#### 7. A zbatohet WWL im për kohën e udhëtimit, trainimin e kërkuar nga DSHS ose kohën e pushimit të paguar (PTO)?

Jo. Koha e udhëtimit, trainimi i kërkuar nga DSHS dhe PTO nuk përfshihen në WWL tuaj. Kjo do të thotë se mund të punoni deri në WWL tuaj duke bërë punë për klientin sipas nevojës, edhe gjatë javëve kur keni trainim të kërkuar, kohë udhëtimi të miratuar ose kur merrni PTO.

## Fletushka e Fakteve mbi Kohën Shtesë për Siguruesit Individualë të Shërbimit

### PAGESA PËR ORËT SHITESË (OT)

#### 8. Si llogaritet OT ime e paguar?

Paguheni pagën tuaj të rregulltë për të gjithë kohën që punoni deri në 40 orë në një javë pune. Për të gjithë kohën që punoni mbi 40 orë, paguheni 1.5 herë të pagës tuaj të rregulltë.

Sistemi i pagesës IPOne paguan shumën e plotë të orëve që punoni në një javë pune sipas pagës tuaj të rregulltë (që quhet “tarifa e plotë”). Ai e tregon OT si një tarifë shtesë ½ për orët OT. Këto shuma gjithsej shtohen së bashku për pagesën përfundimtare.

*Shembull:*

*Punuat 45 orë në një javë pune dhe tarifa juaj e rregulltë është \$12/orë.*

*Pagesa juaj do të jetë:*

*45 orë x \$12 për orë (tarifa e plotë) = \$540*

*+ 5 orë të orëve shtesë x \$6 (qajisma e tarifës) = \$30*

*Gjithsej \$540 + \$30 = \$570*

OT tregohet në Përshkrimin e Përmbledhjes së Pagesës dhe jepet me hollësi në Pjesën e të Ardhurave. Në këtë shembull, Pjesa e të Ardhurave do të tregojë 45 orë të kujdesit personal dhe 5 orë OT.

#### 9. A do të paguhem OT për kohën e udhëtimit, trainimin e kërkuar nga DSHS ose kohën e pushimit të paguar (PTO)?

Do të paguheni OT për kohën e udhëtimit dhe trainimin e kërkuar nga DSHS nëse orët gjithsej që keni punuar në një javë pune janë mbi 40. Orët PTO nuk konsiderohen si orë pune, kështu që ato nuk janë asnjëherë të përshtatshme për pagesë OT.

### INFORMACION PËR IP-të QË KANË NJË WWL TË PËRHERSHËM PREJ 40 ORËSH

#### 10. A mund të punoj më shumë se 40 orë në një javë pune?

Nuk mund të punoni më shumë se 40 orë shërbimi në një javë pune përveç kur keni marë një miratim të posaçëm për klientin nga DSHS për të punuar përkohësisht mbi 40 orë.

#### 11. A mund të punoj më shumë sesa WWL im i përhershëm nëse punoj për shumë klientë?

Duhet të administroni të gjitha orët e shërbimit për klientë brenda WWL tuaj të përhershëm, pavarësisht nga numri i klientëve për të cilët punoni. Nëse punoni për më shumë se një klient, duhet të planifikoni kohën tuaj me secilin prej tyre, për të siguruar se, kur të shtoni të gjitha orët tuaja të shërbimit së bashku, nuk punoni më shumë sesa WWL juaj i përhershëm.

#### 12. Çfarë duhet të bëj nëse klienti për të cilin punoj dëshiron të planifikojë që të punoj më shumë orë sesa kam në dispozicion në WWL tim të përhershëm?

- Shpjegoni se nuk ju lejohet të punoni më shumë sesa WWL juaj dhe se nëse e bëni këtë do të konsiderohet pretendim i tepërt. Shihni #19 për informacion shtesë mbi pretendimin e tepërt
- Mos pranoni detyra që do t’ju shkaktojnë të punoni më shumë sesa WWL juaj.
- Inkurajoni klientin që të përdorë një sigurues tjetër të shërbimit.
- Inkurajoni klientin të kontaktojë menaxherin e çështjes së tij/saj nëse klienti ka vështirësi që të kuptojë kufizimin tuaj ose nuk mund të gjejë sigurues tjetër të shërbimit.
- Ju lutemi shihni #18 në faqen 3 për informacion shtesë mbi nevojat urgjente dhe të menjëhershme.

## Fletushka e Fakteve mbi Kohën Shtesë për Siguruesit Individualë të Shërbimit

### INFORMACION PËR IP-të QË KANË NJË WWL TË PËRHERSHËM PREJ 40.25 ORËSH OSE MË SHUMË

#### 13. A mund të punoj më shumë se 40 orë në një javë pune?

Nëse kemi marë një njoftim me shkrim nga DSHS se WWL juaj i përhershëm është më i madh se 40 ose nëse patët një miratim të rritjes së WWL për një klient të caktuar, përkohësisht, mund të punoni deri në numrin e orëve në njoftimin tuaj.

#### 14. Çfarë duhet të bëj nëse punoj për më shumë se një klient?

Ju lutemi shihni përgjigjen për pyetjen #11.

#### 15. Po nëse klienti për të cilin punoj dëshiron që të ndryshoj orët e mia që të punoj më shumë sesa WWL im i përhershëm në një javë?

Mund të jeni në gjendje të ndryshoni orët tuaja nëse të gjitha nga sa më poshtë janë të vërteta:

- Klienti ka një nevojë; dhe
- Nëse punoni orët shtesë nuk do të kapërceni orët e vlerësuara mujore të klientit; dhe
- Nëse punoni më shumë në një javë nuk do të rezultoni që klienti të mbetet pa kujdes thelbësor në javë të tjera të muajit; dhe
- Nëse punoni më shumë në një javë nuk do të bëjë që të punoni më shumë orë shtesë në muaj sesa do të kishit punuar nëse punuat deri në WWL tuaj çdo javë të atij muaji.

Kur WWL juaj është mbi 40, mund t'i ndryshoni orët tuaja sipas nevojës, përse kohë që nuk punoni më shumë orë shtesë në një muaj sesa do të punonit normalisht. Sasia e orëve shtesë çdo muaj llogaritet duke zbritur 40 orë nga WWL juaj dhe duke shumëzuar pjesën e mbetur me numrin e të shtunave në atë muaj.

#### Shembull:

*WWL e Hozesë është 46 orë. Sasia e orëve shtesë çdo muaj që Hoze mund të punojë varet nga numri i të shtunave në muaj që ai punon.*

*Llogaritja 5 të shtuna:  $46 - 40 = 6 \times 5 = 30$*

*Llogaritja 4 të shtuna:  $46 - 40 = 6 \times 4 = 24$*

*Klienti për të cilin punon Hoze ka nevojë që ai të punojë më një orar fleksibël gjatë muajit, gjë që Hoze mund t'a bëjë, përse kohë që ai nuk punon më shumë se 30 orë shtesë në muajt me 5 të shtuna ose 24 orë shtesë në muajt me 4 të shtuna.*

Gjithashtu mund të dëshironi të ndryshoni orët tuaja që të punoni më shumë sesa WWL juaj nëse klienti për të cilin punoni është duke blerë orë shtesë ekstra me buxhetet e tyre për Shërbimet e Reja të Lirisë ose të Veteranëve të Drejtuara për Kujdesin në Shtëpi.

#### 16. Çfarë duhet të bëj nëse klienti për të cilin punoj dëshiron të planifikojë që të punoj më shumë orë shtesë çdo muaj gjithsej sesa kam në dispozicion në WWL tim të përhershëm?

Ju lutemi shihni përgjigjen për pyetjen #12.

### KUFIRI I PUNËS JAVORE TË PËRKOHËSHME I KAKTUAR PËR KLIENTIN (CSWWL)

#### 17. Çfarë është një CSWWL e përkohëshme?

Klienti për të cilin punoni mund t'i kërkojë DSHS-së që të shtojë përkohësisht WWL tuaj ndërsa ai ose ajo kërkon sigurues shtesë të shërbimit për të përmbushur nevojat e tyre. DSHS do t'ju përgjigjet nëpërmjet postës me një miratim ose refuzim me shkrim. Nëse miratohet, njoftimi gjithashtu do t'ju tregojë datën kur miratimi fillon dhe përfundon dhe numrin e orëve të miratuara. Klienti për të cilin punoni gjithashtu do të marrë një kopje. Kjo kërkesë/njoftim me shkrim njihet gjithashtu si një kërkesë CSWWL. DSHS nuk do të miratojë një kërkesë të përkohëshme WWL që kapërcen orët mujore të vlerësuara të klientit.

## Fletushka e Fakteve mbi Kohën Shtesë për Siguruesit Individualë të Shërbimit

### NEVOJAT URGJENTE

18. Çfarë duhet të bëj nëse kam punuar të gjitha orët në WWL tim, por klienti ka një nevojë urgjente dhe të menjëhershme dhe duhet të vazhdoj të punoj për të ndihmuar me shëndetin ose sigurinë e klientit?

- Qëndroni me klientin derisa situata të jetë e sigurtë dhe e qëndrueshme.
- Nëse ka një urgjencë që kërkon shërbime mjekësore të urgjencës, kontaktoni 9-1-1.
- Përfundoni ditën tuaj të punës sapo të jetë e sigurtë për t'a bërë këtë.
- Kontaktoni menaxherin e çështjes deri ditën tjetër të biznesit për të shpjeguar situatën.

### PRETENDIMI I TEPËRT

19. Çfarë është pretendimi i tepërt?

Pretendimi i tepërt ndodh kur:

- Punoni më shumë orë të shërbimit në muaj sesa jeni të autorizuar për të siguruar; ose
- Punoni orë mbi WWL tuaj që nuk u miratuan nga DSHS; ose
- Pretendoni më shumë kohë të udhëtimit sesa jeni të autorizuar për të siguruar në një javë pune.

20. Çfarë është një Veprim i Kontratës?

Një veprim i kontratës është një njoftim që ju jepet nga DSHS. Njoftimi ju informon se keni punuar më shumë orë shtesë të shërbimit ose orë të kohës së udhëtimit sesa ishit miratuar për të punuar.

21. Çfarë ndodh nëse punoj mbi kufirin e WWL-së ose të kohës së udhëtimit?

- Sa herë që keni një pretendim të tepërt, do të merrni një njoftim me shkrim të veprimit të kontratës dhe informacion nga DSHS që ju kujton rëndësinë që të mos punoni kohë shtesë të pamiratuar. Njoftimi gjithashtu do t'i dërgohet klientit(ëve) për të cilët punoni dhe përfaqësuesve të tyre.
- Në rastin e tretë të pretendimit të tepërt, kontrata juaj mund të përfundojë ose mund të mos keni të drejtë për marë pagesë për 90 ditë. Nëse kontrata juaj ka përfunduar, duhet të prisni 90 ditë përpara sesa të keni të drejtë për të patur një kontratë të re.
- Nëse në mënyrë të konsiderueshme ose të përsëritur kapërceni kufijtë e javës tuaj të punës ose të kohës së udhëtimit, DSHS mund të përfundojë kontratën tuaj për veprim në mospërputhje dhe të mospranojë të bëjë kontratë përsëri me ju.

22. Për sa kohë do të qëndrojnë veprimet e kontratës në dosjen e kontratës time?

Çdo veprim i kontratës do të qëndrojë i hapur për 12 muaj nga data e njoftimit të veprimit të kontratës. Pas 12 muajsh, veprimi i kontratës mbyllet.

23. Si mund të shmang veprime të kontratës?

- Gjithnjë planifikoni paraprakisht orarin tuaj të punës dhe mbajeni shënim.
- Nëse nevojat e klientit ndryshojnë dhe ju duhet të punoni një orar tjetër që ndikon mbi WWL tuaj, kontaktoni menjëherë menaxherin e çështjes së klientit.
- Rregjistroni kohën tuaj të punës në fletën tuaj të punës pas çdo dite që punoni; mund t'ju ndihmojë nëse e rregjistroni gjithashtu në një kalendar letre. Kontrolloni shpesh për t'u siguruar se jeni duke qëndruar brenda WWL tuaj.
- DSHS ka burime në dispozicion për t'ju ndihmuar juve dhe punëdhënësin/klientin tuaj që të mësojë më shumë në lidhje me menaxhimin e orarit tuaj për të qëndruar brenda WWL tuaj. Këto burime janë në dispozicion në [www.dshs.wa.gov/altsa/IPOT](http://www.dshs.wa.gov/altsa/IPOT).